



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 13 qershor 2022
Nr. ref.:AGJ 2007/22

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI196/21

Parashtrues

Gëzim Shtufi

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së
Aktgjykimit PML. nr. 310/2021 të Gjykatës Supreme të Republikës së
Kosovës, të 14 shtatorit 2021**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Gëzim Shtufi (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), me vendbanim në fshatin Shpenadi, komuna e Prizrenit, i cili përfaqësohet nga shoqëria e avokatëve Sejdiu dhe Qerkini.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit [PML. nr. 310/2021] të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, të 14 shtatorit 2021 (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, me të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon se i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 (E drejta për një proces të rregullt gjyqësor) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).
4. Parashtruesi i kërkesës po ashtu kërkon nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) që të vendosë masë të përkohshme për të pezulluar ekzekutimin e dënimit me burgim efektiv, të shqiptuar me Aktgjykimin PAKR. nr. 179/221 të Gjykatës së Apelit dhe të vërtetuar me Aktgjykimin e kontestuar [PML. nr. 310/2021] të Gjykatës Supreme, të 14 shtatorit 2021, derisa Gjykata të marrë vendim për këtë kërkesë.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], paragrafin 2 të nenit 116 [Efektet Juridike të Vendimeve] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës], 27 (Masat e përkohshme) dhe 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 2 nëntor 2021, kërkesa u dorëzua në Gjykatë.
7. Më 5 nëntor 2021, Gjykata e njoftoi përfaqësuesin e parashtruesit të kërkesës dhe Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës KI196/21.
8. Më 8 nëntor 2021, Kryetarja e Gjykatës, Gresa Caka-Nimani, caktoi gjyqtarin Safet Hoxha gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Radomir Laban (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi (anëtarë).
9. Më 11 janar dhe 25 prill 2022, përfaqësuesi i autorizuar i parashtruesit të kërkesës kërkoj që kërkesa për masë të përkohshme të shqyrtohet me urgjencë.
10. Më 26 maj 2021, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës që të shpallë kërkesën të pranueshme. Në të njëjtën ditë, Gjykata njëzëri konstatoi se Aktgjykimi [PML. nr. 310/2021] i 14 shtatorit 2021 i Gjykatës Supreme, nuk është në përputhshmëri me nenin 31 [E Drejta për

Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

Përmbledhja e fakteve të rastit

11. Më 20 shkurt 2015, Prokuroria Themelore në Prizren, ngrii aktakuzën PP. nr. 3063/2013 kundër parashtruesit të kërkesës dhe dy personave të tjerë S. D. dhe Z. Th., të gjithë nga Komuna e Prizrenit, për veprën penale të “kanosjes” nga neni 185, paragrafi 1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPRK).
12. Më 19 qershor 2015, Gjykata Themelore në Prizren, nëpërmjet Aktgjykimit [P. nr. 333/15], refuzoi aktakuzën e ngritur kundër parashtruesit dhe të akuzuarve, sepse prokurorja e çështjes para përfundimit të gjykimit të çështjes ishte tërhequr nga aktakuza, nga shkak se në seancën e shqyrtimit kryesor i dëmtuari L. Sh. hoqi dorë nga ndjekja e mëtejme penale, kundër të akuzuarve, duke deklaruar se me të njëjtit *“kam arritur gjuhën e pajtimit dhe të mirëkuptimit”*.
13. Më 9 dhjetor 2016, Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti për krime të rënda (në tekstin e mëtejme: Prokuroria Themelore), ngrii aktakuzën [PP. nr. 274.2015] kundër K. D., për shkak të dyshimit të kryerjes së veprës penale “fajdja” nga neni 343, paragrafi 3, lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, K. B., për shkak të dyshimit të kryerjes së veprës penale të “fajdes në ndihmë” nga neni 343, paragrafi 3, lidhur me paragrafin 33 të KPRK-së, dhe parashtruesit të kërkesës këtë radhë për shkak të dyshimit të kryerjes së veprës penale të “detyrimit” nga neni 340, paragrafi 2, lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së dhe veprës penale të “mbajtjes në pronësi, kontroll ose në posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 374, paragrafi 1 i KPRK-së. Që të gjithë të akuzuarit janë nga Komuna e Prizrenit.
14. Më 21 shtator 2017, Gjykata Themelore në Prizren (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore), nëpërmjet Aktgjykimit P. nr. 224/16, i) e liroi parashtruesin e kërkesës nga aktakuza për veprën penale të “detyrimit” nga neni 340, paragrafi 2, lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, ndërsa ii) e shpalli atë fajtor për veprën penale të “mbajtjes në pronësi, kontroll ose në posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 374, paragrafi 1 i KPRK-së, duke e dënuar me gjobë në shumën prej 2500 euro. Në lidhje me veprën penale të “detyrimit”, gjykata në fjalë konstatoi se parashtruesi i kërkesës me Aktgjykimin [P. nr. 333/15] të 19 qershorit 2015 për këtë vepër penale ishte liruar më parë nga të gjitha pikat e aktakuzës, dhe se bazuar në nenin 34 të Kushtetutës *“askush nuk mund të gjykohet më shumë se një herë për të njëjtën vepër”*.
15. Kundër Aktgjykimit të lartcekur, ankesë parashtruan edhe parashtruesi i kërkesës edhe Prokuroria Themelore. Parashtruesi i kërkesës për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, konstatimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit mbi sanksionin penal. Ndërsa, Prokuroria Themelore për pjesën liruese të Aktgjykimit, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe në lidhje me sanksionin penal.
16. Më 26 dhjetor 2017, Gjykata e Apelit, nëpërmjet Aktvendimit PAKR. nr. 541/2017, i) refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës, përkitazi me shpalljen e tij fajtor për veprën penale të “mbajtjes në pronësi, kontroll ose në posedim të paautorizuar të

armëve”, duke e vërtetuar në këtë pjesë Aktgjykimin [P. nr. 224/16] e Gjykatës Themelore, ndërsa sa i përket lirimit nga aktakuza për veprën penale të “detyrimit”, e anuloi Aktgjykimin [P. nr. 224/16] e Gjykatës Themelore, duke e kthyer të njëjtin në rigjykim në prani kësaj të fundit, me arsyetimin se: “është i gabueshëm konstatimi i Gjykatës (Gjykatës Themelore) se i akuzuari Gëzim Shtufi është gjykuar një herë për çështjen e njëjtë penale, nëse i referohemi Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, P. nr. 333/15, të dt.19.02.2015 dhe bëjmë analizimin dhe krahasimin në këtë çështje penale, koha e kryerjes së veprës penale nuk është e njëjtë, shuma e borxhit apo huas së marrë nuk është e njëjtë, dhe përfitimi joproporcional nuk është përmendur, andaj nuk kemi të bëjmë me një çështje të gjykuar edhe pse i dëmtuari dhe i akuzuari janë të njëjtë”. Kryesuese e Kolegjit shqyrtues në këtë vendimmarrje ishte gjyqtarja M.M).

Kthimi i rastit në rigjykim (hera e parë)

17. Më 18 prill 2018, Gjykata Themelore, nëpërmjet Aktgjykimit P. nr. 2/2018, refuzoi sërish aktakuzën e ngritur kundër parashtresit të kërkesës për veprën penale të “detyrimit”, me arsyetimin se kjo çështje ishte gjykuar njëherë dhe se e njëjta ishte bërë *res judicata* me Aktgjykimin [P. nr. 333/15] të 19 qershorit 2015 dhe se i njëjti person nuk mund të gjykohej sërish për të njëjtën vepër penale.
18. Ankesë kundër Aktgjykimit të lartcekur parashtroi Prokuroria Themelore “... për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që Gjykata e Apelit, aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë ta prish dhe të njëjtën ta kthej në rigjykim ose ta ndryshoj, në atë mënyrë që të akuzuarin K.D., K.B., Gëzim Shtufi dhe A.D., t’i shpallë fajtorë duke iu shqiptuar dënimet e parapara me ligj”.
19. Më 9 tetor 2018, Gjykata e Apelit, nëpërmjet Aktvendimit PAKR. nr. 443/2018, anuloi Aktgjykimin [P. nr. 2/2018] e Gjykatës Themelore, të 18 prillit 2018, duke e kthyer sërish çështjen në rivendosje në Gjykatën Themelore, përkitazi me refuzimin e aktakuzës ndaj parashtresit të kërkesës, në lidhje me veprën penale të “detyrimit”. Nëpërmjet këtij aktvendimi, Gjykata Themelore u urdhërua që çështja të gjykohej nga një trup tjetër gjykues. Në arsyetimin e saj, Gjykata e Apelit, ndër të tjera, theksoi se “Meqenëse trupi gjykues i cili ka gjykuar në shkallë të parë nuk i është përmbajtur vërejtjeve dhe udhëzimeve të Gjykatës së Apelit e të cilat konform dispozitave ligjore janë të obliguara, ky kolegji vendosi që në rigjykim kjo çështje penalo-juridike t’i jepet një trupi tjetër gjykues”. Kryesuese e Kolegjit shqyrtues në këtë vendimmarrje ishte sërish gjyqtarja M. M).

Kthimi i rastit në rigjykim (hera e dytë)

20. Më 21 mars 2019, Gjykata Themelore, nëpërmjet Aktgjykimit PKR. nr. 86/2018, refuzoi sërish aktakuzën e ngritur ndaj parashtresit të kërkesës për veprën penale të “detyrimit”, me arsyetimin se kemi të bëjmë me çështje të gjykuar *res judicata*, sepse për këtë vepër penale ekziston një aktgjykim i plotfuqishëm, prandaj kjo rrethanë përbën pengesë për gjykim të sërishëm të kësaj çështje penale, bazuar në parimin *ne bis in idem*.

21. Prokuroria Themelore kundër Aktgjykimit të lartcekur parashtroi sërish ankesë në Gjykatën e Apelit, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozimin që aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

22. Më 8 janar 2020, Gjykata e Apelit, nëpërmjet Aktgjykimit PAKR. nr. 327/2019, anuloi Aktgjykimin [PKR. nr. 86/2018] e Gjykatës Themelore, të 21 marsit 2019, duke e kthyer sërish çështjen në rigjykim në Gjykatën Themelore, duke urdhëruar këtë të fundit, që kjo çështje penale sërish të gjykohej nga një trup gjykues tjetër. Në arsyetimin e saj, Gjykata e Apelit, theksoi se: *"... sa i përket çështjes se a bëhet fjalë për çështje të gjykuar apo jo, nuk qëndron vlerësimi i gjykatës së shkallës së parë, se bëhet fjalë për rast të njëjtë, për të cilin është vendosur me vendim të formës së prerë të Gjykatës Themelore -..., ngase, gjithherë sipas shkresave të lëndës rasti i mëparshëm ka përfunduar në qershor të vitit 2015, ndërsa i dëmtuari pas përfundimit të këtij rasti ka shkuar në polici dhe e ka lajmëruar rastin se i akuzuari edhe më tutje është duke e kërcënuar dhe duke i kërkuar para të dëmtuarit, ku përkitazi me faktet dhe rrethanat në fjalë ka dhënë deklaratë të detajuar dhe gjithmonë ka konstatuar se flitet për rastin pas qershorit 2015".*

- Kthimi i rastit në rigjykim (hera e tretë)*

23. Më 12 janar 2021, Gjykata Themelore, nëpërmjet Aktgjykimit PKR. nr. 3/2020, e shpalli fajtor parashtruesin e kërkesës dhe tre të akuzuarit tjerë, për shkak të kryerjes së veprës penale të detyrimit nga neni 267.2, lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, duke ia shqiptuar të njëjtit dënimin me burgim me kusht në kohëzgjatje prej 1 (një) viti. Në arsyetimin e saj, Gjykata Themelore theksoi se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me çështje të gjykuar, pasi që sipas aktakuzës objekti i shqyrtimit nuk ishte identik me objektin e shqyrtimit në Aktgjykimin P. nr. 333/15, të 19 qershorit 2015, në të cilin thirret parashtruesi i kërkesës.

24. Kundër Aktgjykimit të lartcekur, Prokuroria Themelore parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit, për sa i përket vendimit për sanksionin penal, sipas nenit 387, paragrafët 1 dhe 2 të KPRK-së, duke propozuar që: *"Gjykata e Apelit ta ndryshojë aktgjykimin e ankimuar përkitazi me vendimin mbi dënimin ashtu që të akuzuarit K. D, për shkak të veprës penale Kontraktim i përfitimit jo proporcional, nga neni 270 të KPRK-së, t'i shqiptoj dënim me burg ose dënim me të lartë me gjobë, të akuzuarit K. B, për shkak të veprës penale Kontraktim i përfitimit joproporcional në ndihmë nga neni 270, lidhur me nenin 25 të KPRK-së, t'i shqiptoj dënim me burg ose dënim me të lartë me gjobë, të akuzuarit Gëzim Shtufi (parashtruesi i kërkesës), për shkak të veprës penale Detyrim nga neni 267, par. 2 lidhur me par. 1 të KPRK -së, t'i shqiptoj dënim me burg efektiv dhe të akuzuarit A. D, për shkak të veprës penale Detyrim nga neni 340, par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, t'i shqiptoj dënim me burg ose dënim me gjobë më të lartë".*

25. Më 7 maj 2021, Prokuroria e Apelit, nëpërmjet parashtrësës [PPA/Lnr. 185/21], propozoi që ankesa e Prokurorisë Themelore të aprovohet si e bazuar, të ndryshohet aktgjykimi i ankimuar dhe të akuzuarve K. D., K. B. dhe A. D., t'u shqiptohen dënime me burg ose dënime më të larta me gjobë, ndërsa të akuzuarit Gëzim Shtufi, t'i shqiptohet dënim me burg efektiv.

26. Parashtruesi i kërkesës, nëpërmjet mbrojtjes së tij, në Gjykatën e Apelit parashtroi përgjigje në ankesë, kundër propozimit të Prokurorisë Themelore për ashpërsim të masës së dënimit, duke kërkuar që një propozim i tillë të refuzohet si i pabazuar.
27. Më 14 qershor 2021, Gjykata e Apelit duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Themelore dhe përgjigjes në ankesë të parashtruesit të kërkesës, nëpërmjet Aktgjykimit PAKR. nr. 179/2021, e ndryshoi Aktgjykimin [PKR. nr. 3/2020] e Gjykatës Themelore, të 12 janarit 2021, vetëm sa i përket vendimit për dënimin, duke e rritur dënimin me burgim me kusht nga 1 (një) vit, në dënim me burgim efektiv në kohëzgjatje prej 3 (tri) vitesh. Në arsyetimin e saj, Gjykata e Apelit arsyetoi se gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye se nuk kemi të bëjmë me çështje të gjykuar, edhe pse bëhet fjalë për palë të njëjta në procedurë, veprimi kryesor i të akuzuarit ndryshon, sepse në lëndën e cila është kryer me aktgjykim refuzues i akuzuari (parashtruesi) është ngarkuar për veprën penale të “kanosjes”, ndërsa në rastin konkret i njëjti akuzohet për veprën penale të “detyrimit”.
28. Më 12 korrik 2021, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme, kundër Aktgjykimit [PAKR. nr. 179/2021] të 14 qershorit 2021 të Gjykatës së Apelit, në ndërlidhje me Aktgjykimin [PKR. nr. 3/2020], të 12 janarit 2021 të Gjykatës Themelore, me pretendimin se të njëjtit janë marrë me shkelje të nenit 432, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, në lidhje me nenin 384, paragrafi 1, pika 1.7 dhe pika 1.8, në lidhje me nenin 370, paragrafi 1, pika 6.7 dhe 8, si dhe neni 361 i KPPRK-së, duke arsyetuar se këto shkelje kanë tërhequr edhe shkeljen e nenit 403 të KPPRK-së. Parashtruesi i kërkesës nëpërmjet këtij mjeti juridik kërkoi gjithashtu shtyrjen e ekzekutimit të dënimit me burgim efektiv derisa Gjykata Supreme të nxjerrë vendim meritore për çështjen.
29. Më 14 shtator 2021, Gjykata Supreme, duke vepruar sipas kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të parashtruar nga parashtruesi i kërkesës, nëpërmjet Aktgjykimit PML. nr. 310/2021, refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, ushtuar kundër Aktgjykimit [PAKR. nr. 179/2021] të Gjykatës së Apelit në lidhje me Aktgjykimin [PKR. nr. 3/2020] e Gjykatës Themelore në Prizren, të 12 janarit 2021, duke konfirmuar kështu aktgjykimet e instancave më të ulëta si të drejta dhe të bazuara në ligj, si për nga zbatimi i ligjit penal ashtu edhe për nga zbatimi i dispozitave esenciale të ligjit procedural. Në këtë vendimmarrje pjesë e Kolegjit shqyrtues ishte gjyqtarja M. M.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

30. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme nëpërmjet Aktgjykimit [PML. nr. 310/2021] të 14 shtatorit 2021, i ka shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNj-së, si rezultat i cenimit të (i) paanshmërisë së gjykatës dhe (ii) të së drejtës për një vendim të arsyetuar gjyqësor.

i. Pretendimet përkitazi me “paanshmërinë e gjykatës”

31. Përkitazi me këtë pretendim, parashtruesi i kërkesës argumenton se në gjykimin e rastit të tij penal, ka marrë pjesë tri herë gjyqtarja M. M., dhe atë në dy nivele të ndryshme gjyqësore; së pari si kryesuese e kolegjit në Gjykatën e Apelit në

Aktgjykimin [PAKR. nr. 541/2017], të 26 dhjetorit 2017; së dyti po ashtu si kryesuese e kolegjit në Aktgjykimin [PAKR. nr. 443/2018] të 9 tetorit 2018; dhe së treti si anëtare e kolegjit në Gjykatën Supreme në Aktgjykimin e kontestuar [PML. nr. 310/2021], të 14 shtatorit 2021, veprime që sipas parashtruesit të kërkesës e bëjnë Aktgjykimin e kontestuar të mos jetë në përputhshmëri me kërkesat e të "drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm".

32. Në mbështetje të këtij pretendimi, parashtruesi i kërkesës i është referuar praktikës gjyqësore të GJEDNj-së dhe të Gjykatës, në veçanti rasteve të bashkuara KI187/18 dhe KI11/19, Aktgjykimi i 29 korrikut 2019, si dhe dispozitave relevante të KPPRK-së që e rregullojnë çështjen e përjashtimit të gjyqtarëve në procedurat e rregullta.
33. Parashtruesi i kërkesës tutje argumenton se *"një prej garancioneve themelore që ofron neni 31 i Kushtetutës [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], në ndërlidhje me nenin 6 të KEDNj-së, është gjykimi nga një gjykatë e paanshme. Ky garancion procedural sanksionohet qartë edhe në nenin 39 të KPP-së. Jurisprudenca e GJEDNj-së, të cilën e ka zbatuar me përpikëri edhe Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, vë në dukje në mënyrë të qartë se marrja pjesë e të njëjtit gjyqtar në vendimmarrje gjyqësore në dy shkallë të ndryshme, gjatë vendosjes për meritat e rastit, paraqet cenim të parimit të paanshmërisë së gjykatës ("paanshmëria funksionale"). Ky cenim bëhet edhe më i rëndë në raste penale, kur parashtruesit e kërkesave shpallen fajtorë dhe dënohen me burgim. Një situatë e tillë paraqitet në këtë rast prandaj - për më tepër kur në këtë rast e njëjta gjyqtare ka marrë pjesë në 3 vendimmarrje gjyqësore të rastit penal të parashtruesit të kërkesës dhe atë dy herë në Gjykatën e Apelit, si kryesuese e kolegjit dhe një herë në Gjykatën Supreme. Prandaj, Aktgjykimi i Gjykatës Supreme PML. 310/2021, i datës 14.09.2021, paraqet shkelje flagrante të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 39 të KPP-së."*

ii. Pretendimet përkitazi me shkeljen e të drejtës për një "vendim të arsyetuar gjyqësor"

34. Përkitazi me këtë pretendim, parashtruesi i kërkesës thekson: *"... një prej çështjeve kryesore kontestuese gjatë tërë procedurës penale në këtë rast ishte se a kemi pasur një rast të gjykuar, gjegjësisht a duhet të zgjidhet rasti sipas parimit res judicata dhe ne bis in idem. Gjykata Themelore në Prizren, tri herë ka refuzuar kërkesën ndaj Gëzim Shtufit, parashtruesit të kërkesës në këtë rast, me argumentin e fuqishëm se kemi të bëjmë me një çështje të gjykuar. Gjykata Themelore në Prizren ka mbështetur me elaborime të qarta dhe të qëndrueshme konstatimin e saj se tashmë kishte një vendim gjyqësor të vitit 2015 që ishte bërë i formës së prerë, lidhur me veprimet për të cilat Prokuroria Themelore në Prizren akuzoi parashtruesin e kërkesës. Por, pavarësisht argumenteve të qëndrueshme të Gjykatës Themelore, Gjykata e Apelit tri herë, në mënyrë insistuese, prishi aktgjykimet e Gjykatës Themelore dhe ktheu çështjen në rigjykim, pikërisht për shkak të interpretimit të gabuar që i bëri Gjykata e Apelit zbatimit të parimit res judicata dhe ne bis in idem në rastin konkret. Pas kësaj këmbënguljeje jo të zakonshme të Gjykatës së Apelit, Gjykata Themelore ndryshoi interpretimin e saj që kishte ndjekur në tri aktgjykime radhazi, duke shpallur parashtruesin e kërkesës fajtor. Për më tepër, pas ankesës së paraqitur nga parashtruesit dhe nga ana e Prokurorit të Prokurorisë Themelore, Gjykata e Apelit ndryshoi aktgjykimin e Gjykatës Themelore vetëm për sa i përket lartësisë së dënimit, duke*

e rritur dënimin ndaj parashtruesit (nga dënimi me burgim me kusht, në dënim me tri vite burgim efektiv)”.

35. *Tutje parashtruesi i kërkesës thekson: “... se i është drejtuar Gjykatës Supreme me kërkesë për revizion dhe atë me dy pretendime themelore, ku njëri prej tyre ishte se Gjykata e Apelit dhe Gjykata Themelore me vendimet me të cilat kanë shpallur parashtruesin fajtor dhe e kanë dënuar atë, kanë shkelur parimin e çështjes së gjykuar (res judicata) dhe parimin ne bis in idem (që ndalon zhvillimin e proceseve gjyqësore dy herë për të njëjtën çështje). Gjykata Supreme, përmes Aktgjykimit PML. 310/2021, i cili kontestohet me këtë kërkesë, me asnjë fjalë të vetme nuk ka adresuar këtë pretendim të parashtruesit të kërkesës. Ky jo vetëm që ishte njeri ndër dy pretendimet kryesore të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, por, siç është shumë e qartë, kjo ka qenë ndër çështjet kryesore gjatë tërë procesit penal gjyqësor ndaj parashtruesit të kërkesës. Gjykata Supreme, duke e pasur të qartë se kjo ishte çështja kyçe e procedurës penale kundër parashtruesit të kërkesës, ka bërë një shkelje të rëndë të obligimit që ka për të dëgjuar palët me kujdes, për të peshuar pretendimet dhe argumentet e tyre dhe për të arsyetuar vendimet e veta. Për më tepër, në Aktgjykimin e saj, Gjykata Supreme fillimisht vet e vë në pah se parashtruesi i kërkesës ka ngritur çështjen e parimit res judicata dhe citon, në formë të përmbledhur, argumentet e parashtruesit në këtë drejtim. Përmendja e faktit se parashtruesi në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ngritur pretendime se është shkelur parimi res judicata dhe, në anën tjetër, anashkalimi i plotë i këtij pretendimi tek arsyetimi i Aktgjykimit e bënë Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme të jetë në kundërshtim me të drejtën në vendim të arsyetuar gjyqësor dhe parimin e palës së dëgjuar, që janë garancione thelbësore procedurale të nenit 31 të Kushtetutës. Kur kësaj i shtohet edhe fakti se një prej gjyqtareve të kolegjit të Gjykatës Supreme kishte marrë pjesë në marrjen e aktgjykimeve, kundër parashtruesit të kërkesës në të njëjtin rast edhe Gjykatën e Apelit, kjo nxitë dyshimin se Gjykata Supreme nuk ka pasur argumente për të arsyetuar interpretimet e gabuara të Gjykatës së Apelit lidhur me aplikimin e parimit res judicata në rastin konkret.*
36. *Si përmbledhje, parashtruesi i kërkesës shton se “Standardi i vendimit të arsyetuar gjyqësor, në ndërlidhje me parimin e palës së dëgjuar, si garancion themelor i të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, cenohet kur gjykatat nuk adresojnë pretendimet kryesore të palëve në procedurë. Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, PML. 310/2021, i datës 14.09.2021, ka dështuar të plotësoj standardin e vendimit të arsyetuar gjyqësor. Kjo sepse ai Aktgjykim ka shpërfillur tërësisht pretendimin kryesor të parashtruesit, të paraqitur në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, se në rastin e tij ishte cenuar parimi res judicata”.*
37. *Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që: të shpallë kërkesën të pranueshme; të shqiptojë masën e përkohshme dhe të pezullojë ekzekutimin e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, PML. nr. 310/2021, të 14 shtatorit 2021, si dhe Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, PAKR. nr. 179/21, në ndërlidhje me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren, PKR. nr. 3/2020; të konstatojë se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, PML. nr. 310/2021, i 14 shtatorit 2021, i ka shkelur parashtruesit të kërkesës të drejtat e garantuara me nenet 31 të Kushtetutës; dhe të shfuqizojë Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, PML. nr. 310/2021 dhe çështjen ta kthej në rigjykim.*

Kërkesa për masë të përkohshme

38. Parashtruesi i kërkesës ka kërkuar nga Gjykata të vendosë masë të përkohshme, duke theksuar se shkeljet e nenit 31 të Kushtetutës [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], në ndërlidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, janë të dukshme në këtë rast dhe të argumentuara fuqimisht në këtë kërkesë kushtetuese. Pra, kërkesa është e arsyetuar *prima facie* dhe, nëse ndiqet praktika e deritashme e Gjykatës Kushtetuese, shkelja kushtetuese në këtë rast është evidente. Së dyti, po të dërgohej parashtruesi i kërkesës në vuajtje të dënimit, ai do të mund të pësonte dëm të pariparueshëm. Kjo sepse ai vuan nga një sëmundje e rëndë e zemrës dhe nga Komisioni i Mjekëve në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, ai është sugjeruar të trajtohet jashtë vendit (për shkak se sëmundja e tij nuk mund të kurohet në Kosovë). Siç theksohet në shkresat e lëndës, çështja e gjendjes shëndetësore të parashtruesit është ngritur edhe gjatë seancave në gjykatat e rregullta. Po ashtu, sëmundja e rëndë që e vuan parashtruesi i kërkesës vërtetohet edhe përmes vërtetimit të Komisionit të Mjekëve të QKUK-së, që i është bashkëngjitur kësaj kërkesë. Prandaj, shqiptimi i masës së përkohshme do të evitonte pasojat e mundshme fatale dhe të pariparueshme për shëndetin e parashtruesit që do t'i pësojë po që se fillon ekzekutimi i aktgjykimeve të kontestuara dhe dërgimi i tij në vuajtje të dënimit. Në ndërlidhje me këtë, duhet pasur parasysh se parashtruesi i kërkesës është bashkëshort, mbajtës i familjes dhe prind i disa fëmijëve. Për më tepër, duhet potencuar se shpallja si kundër kushtetues i Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme (PML. nr. 310/2021), do të mund të rezultojë në kthimin e çështjes në rigjykim. Të gjitha argumentet e cekura më sipër e arsyetojnë fuqimisht pranimin e kërkesës për masë të përkohshme dhe pezullimin e ekzekutimit të aktgjykimeve të cekura.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.
3. Gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata, në rrethana të veçanta, konsideron se, në të mirë të drejtësisë, është i domosdoshëm përjashtimi i publikut, ose i përfaqësuesve të mediave, sepse prania e tyre do të përbënte rrezik për rendin publik ose sigurinë kombëtare, interesat e të miturve, ose për mbrojtjen e jetës private të palëve në proces, në mënyrën e përcaktuar me ligj.
4. Çdokush i akuzuar për vepër penale ka të drejtë t'u bëjë pyetje dëshmitarëve dhe të kërkojë paraqitjen e detyrueshme të dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet.
5. Çdokush i akuzuar për vepër penale, prezumohet të jetë i pafajshëm derisa të mos dëshmohet fajësia e tij/saj, në pajtim me ligjin.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6

(E drejta për një proces të rregullt)

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohej shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtojte interesat e drejtësisë.
2. Çdo person i akuzuar për një vepër penale prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht.

Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës

Neni 39

Bazat për përjashtimin e gjyqtarëve

[...]

3. "Gjyqtari përjashtohet si gjyqtar i vetëm gjykues, kryetar i trupit gjykues, anëtar i trupit gjykues, anëtar i Kolegjit të Apelit apo Kolegjit të Gjykatës Supreme nëse ka marrë pjesë në procedura të mëhershme në të njëjtin rast penal, përveç gjyqtarit që ka shërbyer në kolegjin e mundësisë hetuese të veçantë. Megjithatë, një gjyqtar nuk do të përjashtohet kur ai ose ajo ka qenë vetëm i përfshirë në procedurat e mëparshme në të njëjtën çështje penale, si një anëtar i një paneli shqyrtues".

[...]

Pranueshmëria e kërkesës

39. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të parashikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
40. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], si dhe paragrafit 2 të nenit 116 [Efekti Juridik i Vendimeve] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

Neni 113

[Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]

- "1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

[...]

Neni 116

[Efekti Juridik i Vendimeve]

[...]

2. Përderisa procedura të mos përfundojë para Gjykatës Kushtetuese, ajo mund të suspendojë përkohësisht veprimin..., derisa të merret vendimi i Gjykatës, nëse konsideron që aplikimi i veprimit..., mund të shkaktoj dëme të pariparueshme.

[...]”

41. Gjykata në vazhdim shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen tutje në Ligj, përkatësisht me nenet 47, 48 dhe 49 të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 47

[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individit mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48

[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49

[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht ...”.

42. Përkitazi me përmbushjen e kriterëve të lartcekura, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës: i. është palë e autorizuar në kuptim të nenit 113.7 të Kushtetutës; ii. konteston kushtetutshmërinë e një akti të autoritetit publik, përkatësisht Aktgjykimin PML. nr. 310/2021 të Gjykatës Supreme, të 14 shtatorit 2021; iii. ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion, në kuptim të nenit 113.7 të Kushtetutës dhe nenit 47.2 të Ligjit; iv. ka specifikuar qartë të drejtat e garantuara me Kushtetutë, të cilat pretendon se i janë shkelur, ashtu siç

përcaktohet me nenin 48 të Ligjit; dhe v. kërkesën e ka dorëzuar brenda afatit ligjor prej 4 (katër) muajve, siç përcakton neni 49 i Ligjit.

43. Megjithatë, përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtuesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë], përkatësisht me dispozitat (1) (d) dhe (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës, që përcaktojnë:

(1) *“Gjykata mund ta konsideroj një kërkesë të pranueshme, nëse:*

(...)

(d) kërkesa qartëson saktësisht dhe në mënyrë adekuate paraqet faktet dhe pretendimet për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese.

(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtuesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

44. Gjykata konsideron se kërkesa ngre pretendime serioze kushtetuese të arsyetuara dhe se ajo nuk është qartazi e pabazuar në kuptim të rregullit 39 (2) të Rregullores.
45. Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se kërkesa e parashtuesit të kërkesës i përmbush kushtet për vlerësim në merita.

Meritat e kërkesës

46. Në trajtimin e meritave të kësaj kërkesë, Gjykata rikujton që me Aktgjykimin [P. nr. 333/15] të 19 qershorit 2015 të Gjykatës Themelore, parashtuesi i kërkesës ishte liruar nga akuza për kryerjen e veprës penale të “kanosjes” sipas nenit 185, paragrafi 1 të KPRK-së. Prokuroria Themelore, kundër parashtuesit të kërkesës për herë të dytë kishte ngritur aktakuzën PP. nr. 3063/2013 për kryerjen e veprës penale të “detyrimit” nga neni 340.2, lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së dhe për veprën penale të “mbajtjes në pronësi, kontroll ose në posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 374, paragrafi 1 i KPRK-së. Gjykata Themelore, me Aktgjykimin P. nr. 224/16, e kishte liruar parashtuesin nga akuza sa i përket veprës penale të “detyrimit” dhe e kishte shpallur fajtor atë për veprën penale të “mbajtjes në pronësi, kontroll ose në posedim të paautorizuar të armëve” dhe e kishte dënuar me gjobë në shumën prej 2500 euro. Gjykata e Apelit, duke vepruar sipas ankesës së Prokurorisë Themelore, me Aktvendimin PAKR. nr. 541/2017, e kthen çështjen në rigjykim në Gjykatën Themelore, e cila nëpërmjet Aktgjykimit P. nr. 2/2018, e refuzon sërish aktakuzën ndaj parashtuesit të kërkesës për veprën penale të “detyrimit”, duke u thirrur në parimin *res judicata*. Gjykata e Apelit, duke vepruar sipas ankesës së Prokurorisë Themelore, me Aktvendimin PAKR. nr. 443/2018, për herë të dytë e rikthen çështjen në rigjykim në Gjykatën Themelore, e cila nëpërmjet Aktgjykimit P. nr. 86/2018, e refuzon sërish aktakuzën ndaj parashtuesit, duke u thirrur në parimin *res judicata* dhe *ne bis in idem*.

47. Aktgjykimi i Gjykatës Themelore u kontestua sërish nga Prokuroria Themelore në Gjykatën e Apelit, e cila me Aktvendimin PAKR. nr. 327/2019, rikthen për herë të tretë çështjen në rigjykim në Gjykatën Themelore, dhe kjo e fundit me Aktgjykimin

PKR. nr. 3/2020, e shpalli fajtor parashtruesin e kërkesës dhe e dënoi atë me burgim me kusht, në kohëzgjatje prej 1 (një) viti. Kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, ankesë kishte parashtruar Prokuroria Themelore, por vetëm sa i përket lartësisë së dënimit të shqiptuar, me ç'rast Gjykata e Apelit, nëpërmjet Aktgjykimit PAKR. nr. 179/2021, ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore, duke e rritur dënimin nga 1 (një) vit, të dënimit me kusht, në 3 (tre) vite, me burgim efektiv. Parashtruesi i kërkesës kundër këtij Aktgjykimi kishte ushtruar kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, në Gjykatën Supreme, e cila me Aktgjykimin e kontestuar PML. nr. 310/2021, refuzoi kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë dhe vërtetoi aktgjykimet e instancave më të ulëta, duke e lënë në fuqi dënimin e shqiptuar me burgim efektiv në kohëzgjatje prej 3 (tre) vitesh, ndaj parashtruesit të kërkesës.

48. Përkitazi me Aktgjykimin [PML. nr. 310/2021] të 14 shtatorit 2021, të Gjykatës Supreme, Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme i ka shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt gjyqësor) të KEDNj-së, për shkak të cenimit të (i) paanshmërisë së gjykatës dhe (ii) së drejtës për një vendim të arsyetuar gjyqësor.

i. Vlerësimi i Gjykatës përkitazi me paanshmërinë e gjykimit

a) Parimet e përgjithshme

49. Në trajtimin e pretendimit të parë të parashtruesit të kërkesës që ndërlidhet me të drejtën në “gjykim të drejtë” dhe të “paanshëm”, Gjykata do të aplikojë praktikën gjyqësore të GJEDNj-së, mbi bazën e së cilës ajo, bazuar në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë. Rrjedhimisht, sa i përket interpretimit të pretendimeve për shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 të KEDNj-së, Gjykata do t'i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNj-së, si dhe praktikës së saj të konsoliduar.
50. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton se paanësia e një gjykate sipas nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNj-së, bazuar në praktikën e konsoliduar gjyqësore të GJEDNj-së, duhet të përcaktohet sipas (i) testit subjektiv, rrjedhimisht në bazë të bindjes dhe sjelljes personale të një gjyqtari, duke nënkuptuar se një gjyqtar mund të ketë pasur paragjyime personale apo anshmëri në një rast të caktuar; dhe (ii) testit objektiv, rrjedhimisht konstatimit nëse vet gjykata, mes tjerash, përbërja e saj, ka ofruar garancione të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim legjitim në këtë drejtim. (Shih ndër të tjera, rastet e GJEDNj-së, *Miracle Europe KFT kundër Hungarisë*, Aktgjykim i 12 prillit 2015, paragrafët 54 dhe 55; *Gautrin dhe të Tjerët kundër Francës*, Aktgjykim i 20 majit 1998, paragrafi 58; *San Leonard Band Club kundër Maltës*, Aktgjykim i 29 korrikut 2004, paragrafi 58; *Thomann kundër Zvicrës*, Aktgjykim i 10 qershorit 1996, paragrafi 30; *Wettstein kundër Zvicrës*, Aktgjykim i 21 dhjetorit 2000, paragrafi 42; *Korzeniak kundër Polonisë*, Aktgjykim i 10 janarit 2017, paragrafi 46; dhe rastin e Gjykatës KIO6/12, me parashtrues *Bajrush Gashi*, Aktgjykim i 9 majit 2012, paragrafi 45, si dhe rastet e bashkuara të Gjykatës KI187/18 dhe KI11/19, parashtrues *Muhamet Idrizi*, Aktgjykimi i 29 korrikut 2019, paragrafi 50).

51. Më specifikisht, sa i përket testit subjektiv, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNj-së, paanshmëria personale e gjyqtarit duhet të prezumohet deri sa të vërtetohet e kundërta. (Shih, ndër të tjera, rastet e GJEDNj-së, *Mežnarić kundër Kroacisë*, Aktgjykim i 30 nëntorit 2005, paragrafi 30; *Padovani kundër Italisë*, Aktgjykim i 26 shkurtit 1993, paragrafi 26; *Morel kundër Francës*, paragrafi 41; *San Leonard Band Club kundër Maltës*, cituar më lart, paragrafi 59; *Hauschildt kundër Danimarkës*, Aktgjykim i 24 majit 1989, paragrafi 47; *Driza kundër Shqipërisë*, Aktgjykim i 13 nëntorit 2007, paragrafi 75; dhe *Korzeniak kundër Polonisë*, cituar më lart, paragrafi 47). Për sa i përket llojit të provave të nevojshme për të dëshmuar një gjë të tillë, GJEDNj, për shembull, është përpjekur që të vërtetojë nëse një gjyqtar tregon armiqësi ose vullnet të keq për arsye personale. Megjithatë, për të vendosur nëse në një rast konkret ka bazë të mjaftueshme për të determinuar se një gjyqtar i caktuar nuk është i paanshëm, pikëpamja e parashtruesit është e rëndësishme, por jo vendimtare. (Shih, ndër të tjera, rastin e GJEDNj-së, *De Cubber kundër Belgjikës*, Aktgjykim i 26 tetorit 1984, paragrafi 25). Megjithatë, parimi në të cilin duhet të supozohet se gjykata është e liruar nga paragjykimet apo njëanshmëria personale, është i vendosur për një kohë të gjatë në praktikën gjyqësore të GJEDNj-së. (Shih, rastet e GJEDNj-së, *Kyprianou kundër Qipros*, cituar më lart, paragrafi 119; *Micallef kundër Maltës*, Aktgjykim i 15 tetorit 2009, paragrafët 93-94; dhe *Tozicka kundër Polonisë*, Aktgjykim i 24 korrikut 2012, paragrafi 33, si dhe rastet e bashkuara të Gjykatës KI187/18 dhe KI11/19, parashtrues *Muhamet Idrizi*, Aktgjykimi i 29 korrikut 2019, paragrafi 51).
52. Për më tepër, sipas praktikës gjyqësore të GJEDNj-së, përderisa në disa raste mund të jetë e vështirë të gjenden faktet bazuar në të cilat mund të përmbysët prezumimi i paanësisë subjektive të një gjyqtari, kriteret dhe kërkesat për paanësinë objektive përcaktojnë një garanci shtesë për një gjykim të paanshëm. (Shih, rastin e GJEDNj-së *Micallef kundër Maltës*, cituar më lart, paragrafët 95 dhe 101). Duhet të theksohet se në shumicën e rasteve që ndërlidhen me çështje të paanshmërisë, GJEDNj është fokusuar dhe ka gjetur shkelje në aspektin e testit objektiv. (Shih, gjithashtu rastin e GJEDNj-së, *Ramos Nunes de Carvalho e Sá kundër Portugalisë*, Aktgjykim i 6 nëntorit 2018, paragrafi 146; dhe *Korzeniak kundër Polonisë*, cituar më lart, paragrafi 48, si dhe rastet e bashkuara të Gjykatës KI187/18 dhe KI11/19, parashtrues *Muhamet Idrizi*, Aktgjykimi i 29 korrikut 2019, paragrafi 52).
53. Për sa i përket testit objektiv, Gjykata vëren se bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNj-së, kur aplikohet mbi një trup gjykues, duhet të determinohet nëse ndaras nga sjellja personale e cilitdo gjyqtarë, mund të ketë fakte të mjaftueshme të cilat mund të ngrisin dyshime për paanshmërinë e gjykatës. Në këtë aspekt edhe dukja/perceptimi mund të ketë rëndësi, sepse "*drejtësia jo vetëm duhet të zbatohet, por ajo duhet të shihet që po të zbatohet*". (Në këtë kontekst, shih, ndër të tjera, rastin e GJEDNj-së, *De Cubber kundër Belgjikës*, cituar më lart, paragrafi 26). Çështja esenciale është besimi që gjykatat në një shoqëri demokratike duhet të reflektojnë në publik. (Shih, ndër të tjera, rastet e GJEDNj-së, *Castillo Algar kundër Spanjës*, Aktgjykim i 28 tetorit 1998, paragrafi 45; *San Leonard Band Club kundër Maltës*, cituar më lart, paragrafi 60; dhe *Golubović kundër Kroacisë*, cituar më lart, paragrafi 49). Prandaj, cilitdo gjyqtar për të cilin mund të ketë arsye legjitime për të dyshuar në mungesë paanshmërie, duhet të tërhiqet nga vendimmarrja. (Shih, rastin e GJEDNj-së, *Micallef kundër Maltës*, cituar më lart,

paragrafi 98, si dhe rastet e bashkuara të Gjykatës KI187/18 dhe KI11/19, parashtrues *Muhamet Idrizi*, Aktgjykimi i 29 korrikut 2019, paragrafi 53).

54. Tutje, praktika gjyqësore e GJEDNj-së përcakton se situatat në kuadër të të cilave mund të ngritën çështje lidhur me mungesën e paanshmërisë, mund të jenë të (i) natyrës funksionale; dhe (ii) personale. E para, ndërlidhet me ushtrimin e funksioneve të ndryshme brenda një procesi gjyqësor nga i njëjti person ose me lidhje të natyrës hierarkike apo të ndonjë natyre tjetër, në mes gjyqtarit dhe akterëve tjerë në procesin e caktuar gjyqësor. Përkitazi me këto të fundit, niveli dhe natyra e kësaj lidhjeje duhet të ekzaminohet. Këto situata të natyrës funksionale, mund të përfshijnë shembuj të rasteve kur në të njëjtin rast janë ushtruar funksione (i) këshillëdhënëse dhe gjyqësore (për këtë kontekst, shih ndër të tjera, rastet e GJEDNj-së, *Procola kundër Luxembourgut*, Aktgjykim i 8 shtatorit 1995, paragrafi 45; *Kleyn dhe të Tjerët kundër Holandës*, Aktgjykim i 6 majit 2003, paragrafi 200; dhe *Sacilor Lormines kundër Francës*, Aktgjykim i 9 nëntorit 2006, paragrafi 74); (ii) gjyqësore dhe jashtëgjyqësore (për këtë kontekst, shih ndër të tjera, rastin e GJEDNj-së, *McGonnell v. the United Kingdom*, Aktgjykim i 8 shkurtit 2000, paragrafët 52-57); dhe (iii) të ndryshme gjyqësore. Në këtë kontekst, GJEDNJ thekson se vlerësimi nëse pjesëmarrja e të njëjtit gjyqtar në faza të ndryshme të procesit gjyqësor mund të ketë rezultuar në shkelje të kërkesave që ndërlidhen me paanësinë e gjykatës, duhet të vlerësohet nga rasti në rast dhe varet nga rrethanat e secilit rast. Ndërsa e dyta, përkatësisht, ato të natyrës personale, kryesisht ndërlidhen me mënyrën e sjelljes të një gjyqtari përkitazi me një rast ose ekzistencën e lidhjeve me njërin nga palët apo përfaqësuesit të tij/saj në një rast. (Shih për më tepër në këtë kontekst, Udhëzuesin e GJEDNj-së të 30 prillit 2019, për nenin 6 të KEDNj-së, e Drejta në Gjykim të Drejtë (aspekti penal), Pjesa IV. Garancionet e Përgjithshme: Kriteret Procedurale, C. Pavarësia dhe Paanësia, 2. Gjykata e Paanshme, a. Kriteret për vlerësimin e paanësisë (shih, në këtë kontekst rastet e bashkuara të Gjykatës KI187/18 dhe KI11/19, parashtrues *Muhamet Idrizi*, Aktgjykimi i 29 korrikut 2019, paragrafi 54).

b) Aplikimi i parimeve të përgjithshme në rrethanat e rastit konkret

55. Në aplikimin e këtyre parimeve të përgjithshme në rrethanat e rastit konkret, Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës pretendon pikërisht ushtrimin e funksioneve të ndryshme të një gjyqtareje brenda të njëjtit proces gjyqësor, përkatësisht faktin që gjyqtarja M. M. kishte marrë pjesë 3 (tre) herë në gjykimin e këtij rasti penal, dhe atë dy herë si kryesuese e Kolegjit në Gjykatën e Apelit në nxjerrjen e vendimeve [PAKR. nr. 541/2017], të 26 dhjetorit 2017 dhe [PAKR. nr. 443/2018] të 9 tetorit 2018, dhe së fundmi si anëtare e Kolegjit në Gjykatën Supreme në nxjerrjen e Aktgjykimit të kontestuar [PML. nr. 310/2021] të 14 shtatorit 2021, veprime të cilat sipas parashtruesit të kërkesës, kanë rezultuar në shkelje të së drejtës së tij për “gjykim të drejtë dhe të paanshëm”.
56. Në këtë kontekst dhe bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNj-së, Gjykata së pari do të shqyrtojë pretendimet e parashtruesit të kërkesës përkitazi me paanësinë e gjykatës nën kriteret e testit subjektiv.
57. Gjykata rithekson se sa i përket testit subjektiv, paanshmëria personale e gjyqtarit duhet të prezumohet derisa të vërtetohet e kundërta. Parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur asnjë provë e cila do të mund të vinte në dyshim paanshmërinë e

gjqtares M. M. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se në nxjerrjen e Aktgjykimit [PML. nr. 310/2021] të 14 shtatorit 2021, asnjë fakt nuk mund të mbështet konstatimin se gjykata nuk ka qenë e paanshme në kuptimin e testit subjektiv.

58. Rrjedhimisht në vijim, në përputhje me parimet e praktikës gjyqësore të GJEDNj-së, dhe si garanci shtesë për rrethanat e rastit konkret, Gjykata do të shqyrtojë pretendimet e parashtguesit të kërkesës nën kriteret e testit objektiv dhe fillimisht (i) nëse rrethanat e rastit konkret mund të ngrisin dyshime legjitime nga ana e parashtguesit të kërkesës në lidhje me paanshmërinë e gjykatës dhe nëse ky është rasti; dhe (ii) nëse këto dyshime janë objektivisht të justifikueshme. Determinimi i këtyre çështjeve bëhet në secilin rast veç e veç. (Shih, në këtë kontekst, rastet e GJEDNj-së, *Mežnarić kundër Kroacisë*, cituar më lart, paragrafi 31; *Ferrantelli dhe Santangelo kundër Italisë*, Aktgjykim i 7 gushtit 1996, paragrafi 58; *Wettstein kundër Zvicrës*, cituar më lart, paragrafi 44; dhe *San Leonard Band Club kundër Maltës*, cituar më lart, paragrafi 60; *Korzeniak kundër Polonisë*, cituar më lart, paragrafi 49; dhe *Tozicka kundër Polonisë*, cituar më lart, paragrafi 33, si dhe rastet e bashkuar të Gjykatës KI187/18 dhe KI11/19, parashtgues *Muhamet Idrizi*, Aktgjykimi i 29 korrikut 2019, paragrafi 58).
59. Në këtë aspekt, dhe siç është theksuar më lart, ushtrimi i funksioneve të ndryshme brenda të njëjtit proces gjyqësor nga gjyqtari i njëjtë, dhe që ndërlidhet me rrethanat e rastit konkret, paraqet kategori çështjesh të natyrës funksionale dhe të cilat janë relevante në vlerësimin e paanshmërisë së një gjykate. Në raste të tilla, GJEDNj në parim ka mbajtur se ka dyshime legjitime për paanshmërinë e gjykatës. (Shih, ndër të tjera, rastin e GJEDNj-së, *Korzeniak kundër Polonisë*, cituar më lart, paragrafi 51 dhe 52). Të njëjtin qëndrim do të mbaj edhe Gjykata. Rrjedhimisht, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNj-së, Gjykata në vijim do të vlerësojë nëse dyshimet e tilla, në rrethanat e rastit konkret, mund të jenë objektivisht të justifikueshme.
60. Në kuptim të vlerësimit të dyshimeve legjitime në kontekst të rrethanave kur një gjyqtar ka ushtruar më shumë se një funksion në të njëjtën çështje gjyqësore, dy kategori çështjesh janë të rëndësishme. Së pari, vëmendje të veçantë duhet t'i kushtohet karakteristikave të ligjit dhe rregullave që janë të aplikueshme në një rast konkret. (Shih, ndër të tjera, rastet e GJEDNj-së, *Warsicka kundër Polanisë*, Aktgjykim i 16 janarit 2007, paragrafi 40; *Toziczka kundër Polonisë*, Aktgjykim i 24 korrikut 2012, paragrafi 36; dhe *Korzeniak kundër Sllovakisë*, cituar më lart, paragrafi 50). Në këtë kontekst, GJEDNj ka theksuar se të rëndësishme janë edhe çështjet organizative. (Shih, ndër të tjera, rastin e GJEDNj-së, *Piersack kundër Belgjikës*, Aktgjykim i 1 tetorit 1982, paragrafi 30). Për shembull, ekzistenca e procedurave që e sigurojnë paanshmërinë, përkatësisht, rregullave dhe procedurave që e rregullojnë edhe tërheqjen/përrjashtimin e një gjyqtari, është faktorë relevant. (Shih rastet e GJEDNj-së, *Pfeifer and Plankl kundër Austrisë*, Aktgjykim i 25 shkurtit 1992, paragrafi 6; *Oberschlick kundër Austrisë (nr. 1)*, Aktgjykim i 23 majit 1991, paragrafi 50; dhe *Pescador Valero kundër Spanjës*, Aktgjykim i 24 shtatorit 2003, paragrafët 24-29). Së dyti, është e nevojshme të vlerësohet nëse ndërlidhja në mes çështjeve përmbajtësore të shqyrtuara nga i njëjti gjyqtar në faza të ndryshme të procedurës është aq e afërt/dukshme, sa që vë dyshim në paanshinë e gjyqtarit që ka marrë pjesë në vendimmarrje përgjatë këtyre fazave. Ky determinim gjithashtu bëhet nga rasti në rast dhe duke marrë parasysh karakteristikat dhe rrethanat e veçanta të tyre. (Shih, ndër të tjera, rastet e

GJEDNJ-së, *Warsicka kundër Polonisë*, cituar më lart, paragrafi 40; *Toziczka kundër Polonisë*, cituar më lart, paragrafi 36; dhe *Korzeniak kundër Sllovakisë*, cituar më lart, paragrafi 50, si dhe rastet e bashkuara të Gjykatës KI187/18 dhe KI11/19, parashtrues *Muhamet Idrizi*, Aktgjykimi i 29 korrikut 2019, paragrafi 60).

61. Në këtë aspekt, Gjykata, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së të elaboruar më lart, duhet të shtjellojë fillimisht çështjet ligjore dhe rregullative. Gjykata rikujton se procedurat të cilat e rregullojnë tërheqjen/përjashtimin e një gjyqtari nga vendimmarrja janë të një rëndësie të veçantë.
62. Në këtë kontekst, Gjykata vëren që në rastin e parashtruesit të kërkesës në procedurat lidhur me kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë, Gjykata Supreme ka aplikuar dispozitat e KPPRK-së. Ky i fundit, në nenet 39 dhe 40 (Procedura për përjashtim) të tij, specifikisht rregullon çështjen dhe rrethanat në të cilat përjashtohen gjyqtarët nga vendimmarrja përkatëse. Gjykata thekson që paragrafi 2 i nenit 39 të KPPRK-së, shkëljen e të cilit parashtruesi i kërkesës e pretendon, përcakton që:

“Gjyqtari përjashtohet si gjyqtar i vetëm gjykues, kryetar i trupit gjykues, anëtar i trupit gjykues, anëtar i Kolegjit të Apelit apo Kolegjit të Gjykatës Supreme nëse ka marrë pjesë në procedura të mëhershme në të njëjtin rast penal, përveç gjyqtarit që ka shërbyer në kolegjin e mundësisë hetuese të veçantë. Megjithatë, një gjyqtar nuk do të përjashtohet kur ai ose ajo ka qenë vetëm i përfshirë në procedurat e mëparshme në të njëjtën çështje penale, si një anëtar i një paneli shqyrtues”.

63. Gjykata, bazuar në shkresat e lëndës, thekson se në rrethanat e rastit konkret, gjyqtarja M. M. mori pjesë 3 (tre) herë në vendimmarrje të këtij rasti penal dhe atë 2 (dy) herë në nivele të ndryshme gjyqësore. Ajo fillimisht në cilësinë e kryesueses së Kolegjit të Gjykatës së Apelit, ishte pjesë e vendimmarrjes në Aktvendimin [PKRK. nr. 541/2017] të 26 dhjetorit 2017 dhe Aktvendimin [PKRK. nr. 443/2018] të 9 tetorit 2018, dhe në cilësinë e anëtares së Kolegjit shqyrtues mori pjesë në marrjen e Aktgjykimit të kontestuar [PML. nr. 310/21] të Gjykatës Supreme, të 14 shtatorit 2021.
64. Në këtë kontekst, Gjykata thekson se përmbajtja e paragrafit 2 të nenit 39 të KPPRK-së, përkatësisht *“marrja pjesë në procedura të mëhershme në të njëjtin rast penal”*, është e aplikueshme në rrethanat e rastit konkret, dhe në bazë të këtij togfjalëshi, gjyqtarja M. M. është dashur të përjashtohet nga vendimmarrja në kolegjin përkatës të Gjykatës Supreme. Për më tepër, gjyqtarja M. M., në procedurën e mëparshme të vendimmarrjes ishte kryesuese e Kolegjit shqyrtues në Gjykatën e Apelit, ku mori pjesë në nxjerrjen e aktvendimeve të 26 dhjetorit 2017 dhe 9 tetorit 2018, nëpërmjet të cilëve ishte kthyer çështja në rigjykim për sa i përket pjesës liruese të të akuzuarit, gjegjësisht parashtruesit të kërkesës.
65. Gjykata gjithashtu thekson se në rrethana të tilla, përjashtimi i gjyqtarit apo gjyqtares nuk është i varur detyrimisht nga kërkesa e palëve në procedurë. Bazuar në dispozitat e KPPRK-së, gjyqtari vet duhet të kërkojë përjashtimin e tij/saj nga vendimmarrja. Kjo është e përcaktuar në nenet 39 deri 42 të KPPRK-së, dhe gjithashtu mbështetet nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së, e cila thekson rëndësinë e perceptimit dhe besimit që gjykatat duhet të reflektojnë në publik në

një shoqëri demokratike, duke u shprehur në mënyrë të vazhdueshme se cilido gjyqtar që beson që pjesëmarrja e tij ose saj në një çështje gjyqësore, mund të ngrenë dyshime për paanshmërinë e gjykatës, duhet të përjashtohet nga vendimmarrja.

66. Për më tepër, Gjykata gjithashtu rikujton se procedura që ka të bëjë me mbrojtjen e ligjshmërisë nuk parashikon procedurë publike në të cilën parashtruesi mund të marrë pjesë. Kjo procedurë bazohet vetëm në parashtruesat me shkrim. Andaj, për shkak të natyrës së shkruar të procedurës, as parashtruesi i kërkesës dhe as mbrojtësi i tij, nuk kanë mundur të jenë në dijeni, derisa nuk e kanë marrë vendimin e Gjykatës Supreme, se e njëjta gjyqtare që ishte dy herë kryesuese e Kolegjit në Gjykatën e Apelit, mori pjesë edhe në Kolegjin e Gjykatës Supreme që vendosi për kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë. Prandaj, përgjegjësia për mospërjashtimin e gjyqtarës përkatëse nuk mund t'i atribuohet parashtruesit të kërkesës dhe të konkludohet që ai ka hequr dorë nga e drejta që çështja e tij të vendoset nga një gjykatë e paanshme. (Shih, në këtë kontekst rastin e GJEDNJ-së, *Oberschlick kundër Austrisë*, cituar më lart, paragrafi 51, si dhe rastet e Gjykatës KIO6/12, parashtrues: *Bajrush Gashi*, cituar më lart, paragrafi 36, si dhe rastet e bashkuara KI187/18 dhe KI11/19, parashtrues *Muhamet Idrizi*, Aktgjykimi i 29 korrikut 2019, paragrafi 67).
67. Gjykata rikujton se çështja nëse ka apo nuk ka numër të mjaftueshëm të gjyqtarëve për të vendosur për kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë, është çështje krejtësisht nën juridiksion, dhe për diskutim, po qe nevoja, ndërmjet gjyqësorit dhe organeve tjera përgjegjëse. Përgjegjësia primare për administrimin e mirëfilltë të drejtësisë i takon institucioneve relevante dhe çështjet organizative nuk mund të përdoren si arsye për mosrespektim të Kushtetutës. (Në këtë kontekst, shih rastin e Gjykatës, KIO6/12, parashtrues: *Bajrush Gashi*, cituar më lart, paragrafi 51; dhe rastin KO04/11, parashtrues: *Gjykata Supreme e Kosovës*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së neneve 35, 36, 37 dhe 38 të Ligjit për shpronësimin e pronës së paluajtshme, nr. 03/L-139, Aktgjykim i 1 marsit 2012, si dhe rastet e bashkuara KI187/18 dhe KI11/19, parashtrues *Muhamet Idrizi*, Aktgjykim i 29 korrikut 2019, paragrafi 68).
68. Sipas jurisprudencës së GJEDNJ-së, problemet me paanshmërinë, mes tjerash, mund të shfaqen nëse, në faza të tjera të procedurës, gjyqtari tashmë ka shprehur një mendim për fajësinë e të akuzuarit (shih, në këtë kontest GJEDNJ, rastin *Gómez de Liaño y Botella kundër Spanjës*, paragrafi 67-72). Në rrethanat e rastit konkret, vërehet qartë se gjyqtarja M. M., duke qenë kryesuese e kolegjit në Gjykatën e Apelit, ishte shprehur kundër qëndrimeve të Gjykatës Themelore, e cila e kishte liruar parashtruesin e kërkesës nga aktakuza. Me vet faktin që Gjykata e Apelit e kishte kthyer çështjen në rigjykim në Gjykatën Themelore, e cila në fazat e mëvonshme e shpalli fajtor parashtruesin e kërkesës, bazuar në rekomandimet e saj, e që më pas e njëjta gjyqtare mori pjesë, në cilësinë e anëtares së kolegjit në Gjykatën Supreme, ku kjo e fundit nëpërmjet Aktgjykimit të kontestuar [PML. nr. 310/2021] të 14 shtatorit 2021, konfirmoi Aktgjykimin [PAKR. nr. 179/2021] e Gjykatës së Apelit të 14 qershorit 2021, në ndërlidhje me Aktgjykimin [PKR. nr. 3/2020] të Gjykatës Themelore, të 12 janarit 2021, e bën të justifikueshëm pretendimin e parashtruesit të kërkesës për mungesë të paanshmërisë së gjykit të këtij rasti penal.

69. Rrjedhimisht dhe në rrethana të tilla, Gjykata duhet të konstatojë se dyshimet legjitime për paanshmërinë e gjykatës e që rrjedhin si rezultat i ushtrimit të funksioneve të ndryshme të një gjyqtari a gjyqtareje brenda një procesi gjyqësor janë objektivist të justifikueshme. Gjykata, gjithashtu duhet të konstatojë se në nxjerrjen e Aktgjykimit [PML. nr. 310/2021] të 14 shtatorit 2021, Gjykata Supreme nuk ka qenë e paanshme në kuptimin e testit objektiv dhe se rrjedhimisht, është shkelur e drejta e parashtruesit të kërkesës për “*gjykim të drejtë dhe të paanshëm*” nga një gjykatë e paanshme, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNj-së.
70. Gjykata thekson se ky përfundim ekskluzivisht ka të bëjë me Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme, përkatësisht Aktgjykimin [PML. nr. 310/2021] e 14 shtatorit 2021, nga këndvështrimi i paanshësisë së gjykatës në kuptimin e testit objektiv, dhe në asnjë mënyrë nuk e paragjykon rezultatin e meritave të rastit.

ii. Sa i përket pretendimeve tjera

71. Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës gjithashtu ngre pretendime tjera përkitazi me Aktgjykimin e kontestuar [PML. nr. 310/2021] të 14 shtatorit 2021, të Gjykatës Supreme, përkatësisht shkeljen e të drejtës për një vendim të arsyetuar gjyqësor. Megjithatë, Gjykata rikujton se ajo tashmë konstatoi shkelje të parimit të “paanshmërisë së gjykatës” e cila garantohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNj-se, andaj nuk e konsideron të nevojshme ta trajtoj veçmas këtë pretendimin, përderisa Aktgjykimi i kontestuar [PML. nr. 310/2021] i 14 shtatorit 2021 i Gjykatës Supreme, shpallet i pavlefshëm dhe kthehet në rigjykim pranë Gjykatës Supreme, e cila në procedurën e rivendosjes do t’i trajtojë sërish të gjitha pretendimet e parashtruesit të kërkesës, të ngritura në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, tashmë nga një kolegji i ri shqyrtues i Gjykatës Supreme.

Vlerësimi i kërkesës për masë të përkohshme

72. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton se bazuar në nenin 27 (Masat e përkohshme) të Ligjit, Gjykata mund të vendosë masë të përkohshme ndaj një çështjeje që është objekt i procedurës (i) nëse masa është e nevojshme për të evituar rreziqe ose dëme të pariparueshme; ose (ii) nëse marrja e këtyre masave të përkohshme është në interes publik. Këto kritere më tej janë të specifikuara në paragrafin (4) të rregullit 57 të Rregullores së punës.
73. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ka kërkuar vendosjen e masës së përkohshme për të pezulluar ekzekutimin e dënimit me burgim efektiv, në kohëzgjatje prej 3 (tre) vitesh ndaj tij, derisa Gjykata të merr vendim për kërkesën. Gjykata, marrë parasysh faktin se masa e përkohshme lëshohet dhe ka efekt deri në marrjen e një vendimi përfundimtar nga ana e Gjykatës, konsideron se kërkesa për vendosjen e masës së përkohshme në rastin e parashtruesit të kërkesës nuk përbën më objekt të çështjes, ngase tashmë Gjykata ka vendosur për pranueshmërinë dhe meritat e kërkesës së parashtruesit të kërkesës. Rrjedhimisht, kërkesa për masë të përkohshme, për sa më lart, duhet të refuzohet.

Përfundime

74. Si përmbledhje, Gjykata rikujton se nëpërmjet këtij Aktgjykimi, ajo ka shpallur të pavlefshëm vetëm Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, përkatësisht, Aktgjykimin [PML. nr. 310/2021] e 14 shtatorit 2021, të nxjerrë si rezultat i ushtrimit të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë nga parashtuesi i kërkesës, kundër Aktgjykimit [PAKR. nr. 179/2021], të 14 qershorit 2021 të Gjykatës së Apelit, në ndërlidhje me Aktgjykimin [PKR. nr. 3/2020], e 12 janarit 2021 të Gjykatës Themelore në Prizren.
75. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata ka gjetur se Aktgjykimi [PML. nr. 310/2021] i Gjykatës Supreme, i 14 shtatorit 2021 është nxjerrë në kundërshtim me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, sepse (i) është nxjerrë nga përbërja e një Kolegji, në të cilin në kundërshtim me dispozitat përkatëse të procedurës penale, dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës, kishte marrë pjesë gjyqtarja e cila gjithashtu ishte pjesë e vendimmarrjes në fazat e mëhershme të çështjes së njëjtë penale, përkatësisht dy herë në cilësinë e kryesueses së kolegjeve në Gjykatën e Apelit, kur është vendosur për akuzën penale të parashtuesit të kërkesës, dhe së fundmi edhe si anëtare e Kolegjit, kur është vendosur për kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme; dhe në rrethana të tilla, (ii) dyshimet legjitime për mungesën e paanësisë së gjykatës janë objektivist të justifikueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 dhe 116.2 të Kushtetutës, në nenet 20, 27 dhe 47 të Ligjit dhe rregullin 59 (a) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur, më 26 maj 2022, njëzëri:

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;
- II. TË KONSTATOJË se Aktgjykimi [PML. nr. 310/2021] i 14 shtatori 2021 të Gjykatës Supreme nuk është në pajtueshmëri me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1, të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- III. TË SHPALLË të pavlefshëm Aktgjykimin [PML. nr. 310/2021] e 14 shtatorit 2021 të Gjykatës Supreme;
- IV. TË KTHEJË Aktgjykimin [PML. nr. 310/2021] e 14 shtatorit 2021 të Gjykatës Supreme për rivendosje në pajtim me Aktgjykimin e kësaj Gjykate;
- V. TË REFUZOJË kërkesën për masë të përkohshme;
- VI. TË URDHËROJË Gjykatën Supreme, që në pajtim me rregullin 66 (4) të Rregullores së punës, ta njoftojë Gjykatën deri më 25 nëntor 2022, në lidhje me masat e ndërmarra për zbatimin e Aktgjykimit të kësaj Gjykate;
- VII. TË MBETET fuqimisht e angazhuar në këtë çështje në pritje të pajtueshmërisë me këtë urdhër;
- VIII. TË URDHËROJË që ky Aktgjykim t'u kumtohet palëve, dhe në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, të publikohet në Gazetën Zyrtare;
- IX. TË DEKLAROJË se ky Aktgjykim hyn në fuqi ditën e publikimit të tij.

Gjyqtari raportues


Safet Hoxha.

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese




Gresa Caka-Nimani